



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës suaj, datë 06.12.2024, drejtuar Bashkisë Shkodër "Kërkesë për informim", në kuadër të Publikimit të Raportit të Monitorimit të Kontratës Sociale 2023-2027,

Bashkia Shkodër është gjithmonë e angazhuar "Për të drejtën e informimit" .

Referuar pikës 1 të kërkesës nr. 1 ju bëjmë me dije se:

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar, VKM-së nr. 384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM -së nr. 453, datë 3.7.2019 "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti", i ndryshuar, "VKM-së nr. 362, datë 20.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij" po zbaton disa nga programet sociale të strehimit, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim.

Për gjithpërfshirjen e kategorive vulnerabël në aplikimin dhe përfitimin që i njuh ligji, krijimin e lehtësirave të nevojshme për aplikuesit për këto programe dhe shpërndarjen sa më të saktë të informacionit, janë ndjekur këto hapa:

- - Publikimi i shpalljeve në faqen Web për aplikimet për të përfituar nga programet sociale të strehimit që zbaton Bashkia Shkodër;
- - Afishimi në ambientet e Z1N (Zyrës me një Ndalesë), Bashkia Shkodër;
- - Pritje, takime të specialistëve të Sektorit të Strehimit me qytetarët çdo të premtë në ambientet e Bashkisë;
- - Orari i takimeve nga specialistët e Drejtorisë së Shërbimit Social pranë Qendrave Komunitare dhe shpërndarja nga ana e tyre e informacionit në lidhje me programet e strehimit;
- - Fletëpalosje (materiale promociionale).

Referuar pikës 2 të kërkesës nr. 1 ju bëjmë me dije se më poshtë gjeni rregulloren e funksionimit të Këshillit Vendor të Rinisë, që përshkruan strukturën, kompetencat dhe procedurat që ky këshill ndjek për të realizuar detyrat dhe qëllimet e tij dhe listën e anëtarëve:

Qëllimi dhe Objekti

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës së funksionimit dhe organizimit të brendshëm të Këshillit Vendor të Rinisë (KVR), si organ këshillimor që funksionon pranë Kryetarit të Bashkisë.
2. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave bazë të funksionimit, organizimit dhe veprimtarisë si dhe bashkëpunimeve të KVR-së.

Kompetencat e Këshillit Vendor të Rinisë (KVR)

Këshilli Vendor i Rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:

- a) - këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
- b) - vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
- c) - propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;
- d) - bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.

Përbërja e Këshillit Vendor të Rinisë

KVR e Bashkisë Shkodër, përbëhet nga 6 anëtarë si më poshtë:

1. Z. Benet Beci – Kryetar i Bashkisë Shkodër
2. Z. Elsid Sekja – Anëtar
3. Z. Klajdi Kraja – Anëtar
4. Zj. Loreta Çermeli – Anëtar
5. Z. Kledis Dibra – Anëtar
6. Zj. Eleonora Lumçi – Anëtar

Kryetari i KVR-së

Kryetari i KVR-së ka këto detyra si më poshtë:

- a) - Thërret mbledhjet dhe i drejton ato;
- b) - Identifikon propozimet e bëra dhe i hedh ato në votim dhe deklaron numrin e votave;
- c) - Në fund të mbledhjes parashtrohet të gjitha përfundimet dhe konkluzionet e mbledhjes;
- d) - Në përfundim të mbledhjes kryetari propozon dhe hedh për miratim mbledhjen e radhës;

- e) - Emëron anëtarin zëvendësues nga e njëjta kategori në rast se ka dorëheqje nga anëtarët e KVR-së;
- f) - Ndërmerr masa për të zbatuar konkluzionet e mbledhjeve të KVR-së;
- g) - Kujdeset për realizimin e programit dhe planit vjetor të punës së KVR-së;

Anëtarët e KVR-së

Anëtarët e KVR-së kanë këto detyra si më poshtë:

- a) - Anëtarët e KVR mund të thërrasin mbledhje në bazë të nevojave drejtuar sekretariatit teknik;
- b) - Anëtari i KVR-së nuk mund të mungojë më shumë se 3 (tre) mbledhje të njëpasnjëshme për arsye të pajustificuara;
- c) - Cdo anëtar mund të japë dorëheqjen në cdo kohë duke njoftuar me shkrim kryetarin. Kjo kërkesë administrohet nga sekretariati;
- d) - Anëtari ka të drejtën e votës dhe ka të drejtën të parashtrojë propozime për diskutim apo rekomandime për zgjidhje problematikash të cilat kalojnë në miratim.
- e) - Anëtari i KVR-së duhet të deklarojë në sekretariat adresën e tij zyrtare për njoftimet me shkrim.

Sekretariati

1. Sekretariati njofton me shkrim anëtarët e KVR-së, për datën, orën dhe vendin e mbledhjes, të paktën 7 ditë përpara zhvillimit të saj;
2. - Njofton me shkrim anëtarët e KVR-së, në rast anulimi të mbledhjes së planifikuar;
3. - Kryen verifikimin e kuorumit të nevojshëm në fillim të çdo mbledhje;
4. Në rast se konstaton mungesë të përsëritur dhe të pajustificuar të anëtarëve për 3 (tre) herë radhazi është i detyruar të njoftojë kryetarin për lirimin e tij nga detyra dhe zëvendësimin e mandatit;
5. - Mban procesverbalin e zhvillimit të mbledhjes dhe e zbardh atë brenda 5 (pesë) ditëve pune;
6. - Në rast se ndonjë anëtar largohet nga mbledhja, sekretariati verifikon kuorumin e nevojshëm përpara procedurës së votimit.

Mbledhjet e KVR-së

1. KVR mbledhet jo më pak se 4 (katër) herë në vit;
2. Mbledhjet thirren dhe drejtohen nga Kryetari i Bashkisë që është në të njëjtën kohë dhe kryetar i KVR-së.
3. Në mungesë dhe me delegim të kryetarit në mbledhje apo aktivitete të caktuara, kryetari mund të zëvendësohet nga nënkryetari i Bashkisë;
4. Mbledhjet e KVR-së zhvillohen kur janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve. Nëse nuk paraqiten në mbledhje numri minimal i anëtarëve pjesëmarrës, mbledhja shtyhet për një datë të mëvonshme;
5. Mbledhjet zhvillohen duke shqyrtuar të gjitha pikat sipas rendit të mbledhjes, duke hedhur në votim çështje të caktuara të rendit.

Mbajtja e Proçesverbalit

1. Në çdo mbledhjetë Këshillit Vendor të Rinisë mbahet procesverbal;
2. Procesverbali përmban të dhënat themelore për diskutimet e seancës, e veçanërisht konkluzionet, votimet dhe zgjidhjet e miratuara gjatë shqyrtimit të çështjeve të renditë ditës;
3. Pas zbardhjes, sekretariati ja dërgon procesverbalin anëtarëve të KVR-së;
4. Procesverbali miratohet në mbledhjen e radhës me shumicën e votave, secili anëtar i KVR-së ka të drejtë të japë vërejtje mbi procesverbalin, në rast vërejtjeshato hidhen për miratim dhe për çdo vërejtje të miratuar bëhet korrigjimi i procesverbalit dhe miratimi i tij në mbledhjen e ardhshme;
5. Procesverbali nënshkruhet nga sekretariati ose/dhe nga kryetari.

Referuar pikës 3 të kërkesës nr. 1 në lidhje me listën e anëtarëve të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike si dhe rregulloren e funksionimit të këtij këshilli, i gjeni bashkangjitur këtij dokumenti, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr.29, datë 13.06.2022.

Shpresojmë që ky informacion t'ju ndihmojë në përmbushjen e qëllimeve dhe iniciativave të tjera.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,